

Formular për syllabus të lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI I ARTEVE
Titulli i lëndës:	STUDIO E PAVARUR E DIZAJNIT
Niveli:	MA
Statusi lëndës:	OBLIGATIVE
Viti i studimeve:	VITI I
Numri i orëve në javë:	6
Vlera në kredi – ECTS:	12
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Arteve - Studio e Fotografisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ast. Yllka Fetahaj
Detajat kontaktuese:	yllka.fetahaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda “Studio e Pavarur e Dizajnit – Imazhet Eksperimentale” është një kurs kërkimor dhe praktik i avancuar që udhëzon studentët drejt zhvillimit të një projekti original fotografik dhe hulumtues.</p> <p>Kursi ndjek tre faza të ndërlidhura:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Eksplorimi (Inkubatori I) – ku studenti definon temën, pyetjet kërkimore dhe metodologjinë; 2. Krijimi (Inkubatori II) – ku zhvillohet procesi krijues dhe eksperimentimi vizual; 3. Implementimi (Inkubatori III) – ku rezultatet analizohen, interpretohen dhe prezantohen publikisht. <p>Kursi synon të forcojë pavarësinë akademike, mendimin kritik dhe shprehjen artistike, duke kombinuar kërkimin teorik me praktikën eksperimentale në fushën e fotografisë bashkëkohore.</p>
Qëllimet e lëndës	<ul style="list-style-type: none"> - Të zhvillojë aftësitë kërkimore, konceptuale dhe teknike për një projekt të pavarur në dizajn dhe fotografi. - Të nxisë përdorimin e metodave eksperimentale në ndërtimin e imazhit si proces kërkimor. - Të aftësojë studentët për prezantim profesional dhe argumentim teorik të punës së tyre vizuale. - Të përgatisë studentët për temën e diplomës / projektin final të Masterit.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> - Formulojë pyetje kërkimore dhe metodologji të qartë për projektin e tij vizual. - Krijojë dhe zhvillojë fotografi eksperimentale me bazë kërkimore dhe konceptuale. - Analizojë dhe interpretojë rezultatet e procesit krijues në raport me literaturën dhe teorinë. - Dokumentojë dhe prezantojë punën e tij në formë profesionale, vizuale dhe të shkruar. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë	Gjithsej
Ligjërata	2	1	60 orë
Konsultime individuale / mentorim	1	1	30 orë
Ushtrime praktike (studio/laborator)	2	1	60 orë
Punë kërkimore (rishikim literature, formulim pyetjesh, analizë teorike)	-	-	60 orë
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1	30 orë
Zhvillimi i projektit fotografik / eksperimentimi vizual	-	-	60 orë
Koha e studimit vetanak të studentit	-	-	40 orë
Koha e kaluar në vlerësim (prezantim, mbrojtje, ekspozitë finale)	-	-	15 orë
Përgatitja përfundimtare për provim	-	-	5 orë
Totali	360 orë		
Shpjegim i shkurtër i përlogaritjes: <ul style="list-style-type: none"> • 6 orë javore mësim aktiv (2 ligjërata + 2 ushtrime + 1 konsultim + 1 mentorim/disutim kolektiv). • Pjesa tjetër është shpërndarë sipas standardeve akademike për punë vetanake, ushtrime dhe projekte. • Kjo është e përputhshme me një kurs që ka 12 ECTS, pasi 1 ECTS = ~25–30 orë ngarkesë pune. 			
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e kursit bazohet në mentorim individual, kërkim teorik dhe proces të vazhdueshëm eksperimentimi praktik. Mësimdhënia zhvillohet në tri faza që ndërtojnë gradualisht punën e studentit:		

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Inkubatori I – Eksplorimi: formulimi i pyetjeve kërkimore, rishikimi i literaturës, definimi i qëllimit. 2. Inkubatori II – Krijimi: procesi i eksperimentimit vizual dhe zhvillimi i projektit fotografik. 3. Inkubatori III – Implementimi: analiza, interpretimi dhe prezantimi i gjetjeve. <p>Ligjëratat do të shoqërohen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - diskutime dhe analiza vizuale të punëve referuese; - konsultime individuale për zhvillim të ideve; - workshop-e për teknika alternative dhe koncepte eksperimentale; - kritika të hapura dhe prezantime progresive. <p>Ligjërata interaktive me analiza vizuale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parashtrim i koncepteve teorike për imazhin eksperimental, ngjyrën, ndjesinë dhe komunikimin vizual në kontekst bashkëkohor. - Analizë e punëve të autorëve që përdorin eksperimentin si formë kërkimi artistik. - Diskutime kritike mbi rolin e teknologjisë digjitale në procesin krijues dhe në mënyrat e perceptimit vizual. <p>Punë praktike dhe projekte individuale / në grup</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët zhvillojnë projektin e tyre kërkimor dhe vizual përmes fazave të: konceptcionit, eksperimentimit, përpunimit dhe prezantimit. - Puna praktike përfshin eksperimente në studio, terren dhe laborator digjital, duke lidhur kërkimin teorik me praktikën vizuale. - Projekti zhvillohet në mënyrë të pavarur, me konsultime të rregullta me mentorin dhe prezantime progresive para grupit. <p>Workshop-e dhe ushtrime eksperimentale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Seanca intensive që fokusohen në procese alternative, formë, dritë, ngjyrë dhe teksturë, si mënyra të eksplorimit konceptual. - Eksperimentim me teknika digjitale dhe analoge, duke synuar zbulimin e formave të reja të rrëfimit vizual. - Përdorimi i softuerëve të avancuar për ndriçim, simulim, përpunim dhe kompozim digjital.
--	---

	<p>Kritikë dhe feedback formativ</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantime periodike të punës përmes kritikave të hapura, diskutimeve dhe analizave kolektive. - Vlerësimi fokusohet në procesin e zhvillimit, reflektimin dhe qasjen kërkimore që studentët ndërtojnë gjatë punës. - Kritika vizuale është pjesë integrale e procesit formativ në të gjitha fazat e kursit. <p>Analizë vizuale dhe kërkim konceptual</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i aftësive për të lexuar, analizuar dhe ndërtuar imazhe me bazë teorike dhe kërkimore. - Kërkim mbi temat që trajtojnë ndërthurjen mes konceptit, materialitetit dhe përvojës vizuale. - Përdorimi i referencave akademike dhe artistike për të mbështetur ndërtimin e projektit. <p>Përdorimi i teknologjive digjitale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ushtrime që zhvillojnë aftësitë në përpunim, retouching dhe prezantim profesional të punës (Lightroom, Photoshop, InDesign). - Integrimi i mjeteve digjitale në ndërtimin e portofolios, raportit kërkimor dhe prezantimit final. - Përdorimi i teknologjisë si mjet eksperimental dhe jo vetëm teknik. <p>Prezantime të strukturuar dhe dokumentim i procesit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët mësojnë të artikulojnë në mënyrë profesionale procesin e tyre kërkimor dhe krijues, në formë të shkruar dhe vizuale. - Përdorimi i portofolios dhe raportit të projektit si dokumentacion i progresit teknik dhe konceptual. - Përgatitja dhe prezantimi i punës përfundimtare për ekspozitën dhe mbrojtjen e projektit.
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Vlerësimi në këtë kurs bazohet në kombinimin e vlerësimit formativ dhe përfundimtar, me fokus në zhvillimin teknik, estetik dhe konceptual të studentit gjatë gjithë procesit krijues.</p> <p>Qëllimi është të vlerësohet jo vetëm rezultati final, por edhe procesi i punës, reflektimi kritik dhe aftësia për të ndërtuar një qasje personale kërkimore në fushën e imazhit eksperimental.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja dhe angazhimi në ligjërata dhe praktikë – 20% - Detyra praktike dhe ushtrime individuale – 30% - Projekti final / raporti kërkimor dhe tema – 50%
Literatura	
Literatura bazë:	<i>Liz Wells (ed.) – Photography: A Critical Introduction</i> <i>Charlotte Cotton – The Photograph as Contemporary Art</i> <i>James Elkins – What Photography Is</i> <i>Geoffrey Batchen – Each Wild Idea: Writing, Photography, History</i>
Literatura shtesë:	<i>David duChemin – Within the Frame: The Journey of Photographic Vision</i> <i>Roland Barthes – Camera Lucida: Reflections on Photography</i> <i>Michael Freeman – The Photographer’s Mind</i> <i>John Berger - Ways of Seeing</i> <i>Susan Sontag – On Photography</i> <i>Clive Scott – The Spoken Image: Photography and Language</i>
Burimet:	
https://www.biblioteka-ks.org/ https://bibliotekadigjitale-ks.org/documents https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,137 https://www.gutenberg.org/ https://www.springer.com/gp/open-access/books https://doabooks.org/ https://www.magnumphotos.com/ https://aperture.org/ https://lensculture.com/ https://www.tate.org.uk/art/art-terms/p/photography https://photoresourcehub.com/ https://masters-of-photography.com/	

Java	Tema / Njësia Mësimore	Përmbajtja Kryesore	Aktivitetet Mësimore	Detyra / Vlerësimi
1	<i>Hyrje në lëndë dhe prezantimi i syllabusit</i>	Prezantimi i qëllimeve, metodologjisë dhe mënyrës së vlerësimit.	Diskutim hyrës, prezantim lënde	Ditar reflektiv
2–4	<i>Inkubatori I – Eksplorimi</i>	Zgjedhja e Temës dhe Formulimi i Pyetjeve të Kërkimit: Identifikoni temën e përgjithshme të punës suaj dhe formuloni pyetjet e kërkimit që dëshironi të zgjidhni. Përcaktoni pse kjo temë është e	Konsultime individuale dhe grupore	Diskutim dhe Pune individuale

		rëndësishme dhe cila është kontributi juaj në fushën e fotografisë.		
5-6	Inkubatori I – Rishikimi i literaturës	Identifikimi i burimeve, teorive dhe metodave ekzistuese. Hulumtoni literaturën ekzistuese për të kuptuar punën e mëparshme të bërë në fushën e fotografisë. Identifikoni teoritë, metodat dhe shpikjet kryesore që lidhen me temën tuaj.	Punë kërkimore dhe diskutim	Raport literaturor
7-8	Inkubatori I – Formulimi i Hipotezës dhe Qëllimit të Studimit:	Përkufizimi i qëllimit dhe arsytimit të projektit. Bazuar në shqyrtimin e literaturës dhe njohuritë tuaja, formuloni një hipotezë për punën tuaj dhe përcaktoni qëllimin e përgjithshëm të studimit.	Diskutim mentorues	Dorëzim i dokumentit të konceptit
9-10	Inkubatori I – Metodologjia e kërkimit	Përshkrimi i teknikave, burimeve dhe mjeteve të përdorura. Përshkruani metodat që do të përdorni për të kryer hulumtimin tuaj në fushën e fotografisë. Përfshini përshkrimin e teknikave, burimeve dhe mjetet që do të përdorni.	Ligjëratë dhe workshop kërkimor	Dorëzim i metodologjisë
11-15	Përgatitja për fazën e krijimit	Përmbledhje dhe prezantim i planit kërkimor para grupit.	Prezantim / kritikë	Vlerësim semestral I
16-18	Inkubatori II – Krijimi	Eksplorimi fotografik: Një fazë e rëndësishme është eksplorimi i temës së punës suaj nëpërmjet fotografisë. Bëni fotografi, eksperimentoni me stile dhe teknika, dhe shprehni idetë tuaja nëpërmjet mediumit të fotografisë.	Ushtrime praktike dhe eksperimentale	Punë eksperimentale

19-21	<i>Inkubatori II – Krijimi fotografik i projektit</i>	Zhvillimi i serisë fotografike bazuar në pyetjet kërkimore. Kjo fazë përfshin krijimin e projektit fotografik bazuar në pyetjet e kërkimit dhe hipotezën tuaj. Fotografitë dhe projektet tuaja duhet të reflektojnë synimet dhe gjetjet e hulumtimit tuaj.	Punë në studio / terren	Dorëzim i serisë së parë
22	<i>Kritikë vizuale dhe reflektim</i>	Diskutim mbi rezultatet dhe procesin e punës.	Kritikë kolektive	Feedback formativ
23	<i>Inkubatori III – Analiza dhe Interpretimi:</i>	Analiza dhe interpretimi i rezultateve Analizoni dhe interpretoni rezultatet e fotografive dhe projektimit tuaj. Lidhni gjetjet me hipotezën dhe literaturën ekzistuese.	Diskutim dhe Pune individuale	Diskutim dhe Pune individuale
24	<i>Inkubatori III – Shpallja e Gjetjeve, Përmbyllja dhe Diskutimi i Pasojave:</i>	Përcaktoni dhe shpallni gjetjet tuaja në mënyrë të qartë dhe të argumentuar. Diskutoni ndryshimet dhe kontributet që keni bërë në fushën e fotografisë. Përmbyllni temën tuaj duke rishikuar shkurtimisht gjetjet kryesore, duke diskutuar pasojat e punës suaj, dhe duke përfshirë sugjerime për hulumtime të ardhshme në këtë fushë.	Konsultime individuale dhe grupore	Diskutim dhe Pune individuale
25-28	<i>Fillimi i Layout te temes dhe orintimi</i>	Përgatitja e strukturës së dokumentit final të temës së masterit. Orientimi mbi renditjen e kapitujve, mënyrën e prezantimit vizual dhe integrimin e elementeve grafike dhe tekstuale.	Konsultime individuale për layout, dizajn dhe renditje të përmbajtjes; rishikim i tekstit dhe imazheve përfundimtare.	Diskutim dhe Pune individuale
27-28	<i>Finalizimi i temes te masterit</i>	Përmbyllja e analizave, redaktimi i raportit përfundimtar, kontrolli i	Dorëzimi i draftit përfundimtar të	Feedback formativ

		bibliografisë dhe përgatitja e versionit për printim.	raportit kërkimor dhe projektit vizual. Feedback i fundit nga mentori.	
29	<i>Përgatitja e prezantimit final</i>	Simulimi i prezantimit para panelit	Praktikë e folurit dhe strukturimit	Provë prezantimi
30	<i>Prezantimi final i projektit</i>	Mbrojtja e temes para komisionit	Prezantim + kritikë	Vlerësim i projektit final

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata, ushtrime praktike dhe punë në terren është **e obligueshme**. Studentët pritet të jenë të përgatitur për çdo orë, të marrin pjesë aktivisht në diskutime dhe të dorëzojnë detyrat e tyre **brenda afateve të përcaktuara**. Pjesëmarrja në **kritikat vizuale**, diskutimet kolektive dhe prezantimet publike është pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit.

Mësimdhënësi është në dispozicion për **konsultime individuale dhe grupore**, për të sqaruar aspektet teknike dhe konceptuale të punës fotografike. Studentët **inkurajohen të kërkojnë sqarime** gjatë orëve dhe të marrin iniciativë në procesin e tyre krijues.

Pas çdo ligjërate, studentët duhet të lexojnë **materialet e rekomanduara** dhe të përgatisin ushtrimet që lidhen me temën javore. Në kuadër të lëndës, kërkohet **përgjegjësi individuale, respekt për pajisjet fotografike dhe kujdes gjatë punës në studio dhe laborator. Plagjiatura dhe manipulimi joetik i imazhit nuk lejohen.**

Studentët duhet të respektojnë orarin, të jenë të rregullt në vijim, dhe të tregojnë sjellje profesionale gjatë ligjëratave, ushtrimeve dhe prezantimeve.